R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 505/2 prot. Tiranë, më 13.02.2026

VENDIM

Nr. 05, datë 13.02.2026

PËR KONTROLLUESIN "ARLO TRAVEL-BLU TOUR OPERATOR" SHPK

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024, "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit "*Arlo Travel-Blu Tour Operator*" shpk (në vijim, "*Kontrolluesi*"),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 232, datë 30.10.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me numër identifikimi L01305031H, në Tiranë, i cili ka si objekt aktiviteti: "*Agjensi udhëtimi dhe operator turistik; bileta të transportit ajror, detar, etj., dhe siguracione; Organizimi i udhëtimeve/pushimeve individuale ose në grup brenda ose jashtë vendit, si dhe ndërmjetësimin në shitjen e produkteve të këtij aktiviteti*."

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë "*klientë*", "*punëmarrës*", etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejimit (CCTV), nëpërmjet të cilit kryen monitorimin e ambienteve fizike gjatë ushtrimit të aktivitetit, për qëllim të sigurisë së nëpunësve dhe aseteve. Sistemi i survejimit CCTV kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), në kundërshtim me parashikimet e neneve 6 dhe 7 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit "*Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*", i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 11*").

   Zyra e Komisionerit vlerëson se një nga mjetet më të përdorura për përpunimin e të dhënave personale është sistemi i survejimit audio dhe/ose video (CCTV). Të dhënat e përpunuara dhe të ruajtura përmes këtyre sistemeve, si pamjet video, imazhet dhe të dhënat zanore (audio), janë të dhëna personale në kuptim të Ligjit.

   Përpunimi i këtyre të dhënave duhet të kryhet në përputhje me parimet e përpunimit të parashikuara në nenin 6 të Ligjit, si ligjshmëria, drejtësia dhe transparenca, kufizimi i qëllimit, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i afatit të ruajtjes, si dhe integriteti dhe konfidencialiteti i të dhënave. Në rastin konkret, vendosja e kamerave në ambientet e brendshme të punës (zyra dhe korridor), sjell përpunim të panevojshëm, pasi Kontrolluesi nuk ka arritur në asnjë moment të provojë se ndodhet në një nga kushtet e parashikuara në pikën 10.3 të Udhëzimit Nr. 11 të Komisionerit, në të cilin parashikohen në mënyrë shteruese, rastet kur kamerat e vëzhgimit mund të drejtohen në një vend pune të veçantë. Në këtë kontekst, përpunimi i të dhënave personale përmes CCTV në ambientet e brendshme është në kundërshtim me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin, të parashikuar në pikën 2 të nenit 6 të Ligjit.

   Gjithashtu, Kontrolluesi ka detyrimin që çdo përpunim të mbështetet në një kriter të qartë ligjor, sipas parashikimeve të nenit 7 të Ligjit. Përpunimi i të dhënave pa një bazë ligjore, si dhe pa informuar subjektet e të dhënave, përbën përpunim të paligjshëm të të dhënave personale. Ky proces përpunimi nëpërmjet sistemit CCTV cenon të drejtat dhe liritë themelore të subjekteve të të dhënave.

   Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se mbikëqyrja e ambienteve të brendshme të Kontrolluesit përmes sistemit të survejimit video, duhet të kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

3. Kontrolluesi ka publikuar në faqen zyrtare https://udheto.com.al rubrikën "*Politikat e Privatësisë*", të cilat janë modele standarde ndërkombëtare të politikave të privatësisë.

   Pas marrjes dijeni të urdhrit të hetimit, Kontrolluesi ka përditësuar rubrikën "*Politikat e Privatësisë*" në faqen e internetit. Megjithatë, nga verifikimet e kryera rezulton se,

subjektet e të dhënave nuk informohen në mënyrë të plotë për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, të drejtën për fshirje dhe/ose korrigjim të të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, faqja zyrtare e internetit përbën zakonisht pikën e parë të kontaktit ndërmjet Kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, ndaj mungesa e një politike ose publikimi i saj në mënyrë jo të plotë i kufizon informacionin e nevojshëm të subjekteve mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, publikimi i "*Politikës së Privatësisë"* është thelbësor për ushtrimin efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave. Vetëm përmes informimit të plotë sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit, subjektet e të dhënave mund të njihen me të drejtat e tyre dhe me mënyrën për t'i ushtruar ato, duke shmangur situatat ku këto të drejta mbeten formale dhe të pazbatueshme në praktikë. Njëkohësisht, ato shërbejnë si mjet parandalues ndaj praktikave jo ligjore ose të njëanshme të Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

4. Konstatohet se, Kontrolluesi ka nënshkruar një kontratë shërbimi me "Albguardia" shpk, datë 05.01.2021, me objekt "*Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike*".

   Nga analizimi i përmbajtjes së marrëveshjes së mësipërme konstatohet se, nuk specifikohen masat konkrete tekniko-organizative të detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*", i ndryshuar (në vijim, "*Udhëzimi nr. 19*").

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo delegim i përpunimit të të dhënave personale duhet të realizohet përmes një kontrate të shkruar dhe të detajuar, e cila përcakton qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave, masat e sigurisë që do të zbatojë përpunuesi, përgjegjësitë ligjore dhe procedurat për kontrollin dhe raportimin. Kjo siguron që delegimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit.

   Gjithashtu, për të përmbushur kërkesat e Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, kontrata aktuale midis palëve duhet të rishikohet duke përfshirë masat tekniko-organizative, detyrimet e qarta të përpunuesit dhe përgjegjësitë në rast shkeljeje. Në këtë mënyrë mund të sigurohet që përpunimi i të dhënave personale nga "*Albguardia*" të kryhet në mënyrë të ligjshme dhe të sigurt, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk disponon "*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, masat teknike dhe organizative etj., në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

   Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi i procedurave të brendshme rregullatore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, sipas kërkesave të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", demonstron mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale.

   Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi dhe zbatimi i rregullores është një detyrim kryesor për Kontrolluesin në përputhje me nenin 27 dhe 28 të Ligjit. Në të duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave.

6. Kontrolluesi nuk ka marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme, për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*").

   Për sa më sipër, rezulton mos përmbushje e detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për sa i takon mbrojtjes së të dhënave personale, të parashikuar në Udhëzimin nr. 47, të Komisionerit.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

   SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO 27001, sipas versionit më të fundit të përditësuar, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018 të Komisionerit "*Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së*

informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" (në vijim, "*Udhëzimi nr. 48*") i cili është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

7. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit.

   Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese, që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

   Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore, të zhvilluar më datë 11.12.2025, paraqiti pretendimet me shkrim mbi konstatimet e procesverbalit, si vijon:

- Lidhur me konstatimet e pikës 2 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Ky konstatim nuk qëndron dhe bie ndesh si me dispozitat ligjore të ligjit nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", po ashtu dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2021 të Komisionerit "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar, i cili në pikën 10, 10.1 të tij parashikon: "10. Kamera vëzhgimi në vendin e punës"10.1 Punëdhënësi mund të përdorë një sistem të vëzhgimit të vazhdueshëm në ambientet e punës bazuar në përdorimin e pajisjeve teknike që transmetojnë imazhe ose të dhëna (kamera survejimi) për qëllime sigurie personale të punonjësve dhe personave të tjerë në këto ambiente për mbrojtjen e pronës dhe për parandalimin ose hetimin e situatave që rrezikojnë sigurinë. Referuar sa më sipër, Udhëzimi nr. 11 e lejon monitorimin e ambienteve të punës, përfshirë ambientet e brendshme si zyra, korridore, hapësira pune, për qëllime sigurie, mbrojtjen e pronës dhe parandalimin e incidenteve...*

Përdorimi i CCTV në ambientet e punës është i detyrueshëm. Administratori shprehet se ka qenë i detyruar të vendosë kamera sigurie, të orientuara nga policia...".

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Instalimi i sistemit të survejimit CCTV në ambientet e punës ku fokusohen punonjësit, cenon privatësinë e tyre dhe është në kundërshtim me parimin e minimizimit, referuar pikës 3, të nenit 6 të Ligjit, kriteret ligjore të përpunimit, dhe Udhëzimin nr. 11 të Komisionerit, në përmbajtje të të cilit parashikohet se përdorimi i një sistemi vëzhgimi të vazhdueshëm në ambientet e punës përdoret vetëm për qëllim të sigurisë personale të punonjësve dhe të personave të tjerë në këto ambiente, për mbrojtjen e pronës dhe për parandalimin e situatave që rrezikojnë sigurinë, por jo për mbikëqyrjen e punonjësve në vendin e punës.

Mbikëqyrja nëpërmjet sistemit të video-survejimit i ambienteve të brendshme (zyrave dhe korridorit), bie në kundërshtim me parimin e përpunimit në përputhje me qëllimin, të përcaktuar në pikën 2, të nenit 6 të Ligjit dhe nenin 2, të Udhëzimit nr. 3, pasi ekspozon subjektet e të dhënave ndaj ruajtjes së panevojshme dhe jo proporcionale të materialeve vizuale, duke rritur riskun mbi privatësinë e individëve.

Gjithashtu, nuk jemi në kushtet e parashikuara në pikën 10.3 të Udhëzimit nr. 11, për rrjedhojë nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në të. Për më tepër, edhe pse Udhëzimi e lejon mundësinë e mbikëqyrjes përmes sistemit të video-survejimit në vendin e punës, kjo kërkon një rregullim të veçantë, ku të përcaktohen shprehimisht qëllimi i vendosjes së sistemit CCTV në ambientet e punës, planet e vendosjes, afatet e ruajtjes së të dhënave dhe masat tekniko-organizative për garantimin e ligjshmërisë së përpunimit.

- Lidhur me konstatimet e pikës 3 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Nuk jemi dakord me konstatimin e mbajtur nga grupi hetimor, pasi në faqen tonë zyrtare të internetit (https://udhëto.com.al/politika-e-privatesise/) janë të publikuara Politikat e Privatësisë, të hartuara në mënyrë të detajuar dhe në përputhje të plotë me nenin 13 të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Politikat e privatësisë përmbajnë të gjithë elementët që ligji kërkon, konkretisht: identitetin dhe kontaktet; qëllimin e përdorimit të të dhënave; sigurinë e të dhënave; privatësinë e fëmijëve; të drejtat e subjekteve të të dhënave, përfshirë të drejtën për fshirje dhe korrigjim; mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe kontaktet përkatëse; marrësit e mundshëm të të dhënave; periudhat e ruajtjes etj. Politikat e privatësisë janë publike, të aksesueshme dhe transparente, për çdo palë që kërkon të informohet se për çfarë do të përdoren të dhënat e tyre personale dhe për këtë arsye, mendojmë se konstatimi i bërë nuk është i saktë dhe nuk pasqyron situatën reale...*".

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Referuar nenit 13 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin ligjor që të sigurojë informimin e plotë, të qartë, të saktë dhe të aksesueshëm të subjekteve të të dhënave për përpunimin e të dhënave të personale, përpara ose në momentin e mbledhjes së tyre. Publikimi formal i

"*Politikave të Privatësisë*", nuk përbën përmbushje automatike të detyrimeve ligjore, nëse këto politika nuk reflektojnë saktë dhe në mënyrë transparente proceset konkrete të përpunimit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për informim ekziston për çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht nga forma e përpunimit, si dhe pavarësisht nga fakti nëse mbledhja e të dhënave realizohet drejtpërdrejt përmes faqes zyrtare të internetit apo përmes mjeteve të tjera. Faqja e internetit përbën pikën e parë të kontaktit të subjektit të të dhënave me Kontrolluesin dhe, për këtë arsye, informimi i subjekteve të të dhënave të duhet të jetë gjithëpërfshirës, i përditësuar dhe në përputhje me nenin 13 të Ligjit.

- Lidhur me konstatimet e pikës 4 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Nuk jemi dakord me konstatimin e grupit hetimor. Kontrata me "Albguardia" shpk ka për qëllim vetëm shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit dhe nuk përfshin mbrojtjen e të dhënave personale në mënyrë të drejtpërdrejtë. Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe çdo përpunim i të dhënave personale nga ana e tyre kryhet sipas udhëzimeve tona dhe procedurave të brendshme të shoqërisë, në përputhje të plotë me nenin 26, 28 dhe Udhëzimin nr. 19. Masat tekniko-organizative për mbrojtjen e të dhënave janë të parashikuara në politikat tona të privatësisë për subjektet që kanë interes (klient ose jo), si dhe në kontratën e punës (për punonjësit). Për rrjedhojë edhe ky konstatim i bërë nga ana juaj nuk pasqyron situatën reale...".*

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Mos reflektimi në përmbajtjen e kontratës së shërbimit me subjektin "Albguardia" shpk i detyrimeve dhe përgjegjësive të Kontrolluesit dhe Përpunuesit, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, sjell mungesë të garancive kontraktore lidhur me sigurinë, integritetin dhe përgjegjshmërinë mbi përpunimin e të dhënave personale të punonjësve. Kjo situatë krijon pasiguri juridike për rolet dhe përgjegjësitë në kuadër të përpunimit të deleguar dhe rrit mundësinë e cenimit të konfidencialitetit të të dhënave personale që përpunohen.

  Bazuar në pikën 3 të nenit 26 të Ligjit, përpunimi duhet të kryhet në bazë të një kontrate me shkrim, të një ligji ose akti nënligjor, i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga përpunuesi në raport me kontrolluesin e që përcakton *objektin dhe kohëzgjatjen e përpunimit, natyrën dhe qëllimin e përpunimit, llojin e të dhënave personale dhe kategoritë e subjekteve të të dhënave, si dhe të drejtat dhe detyrimet e kontrolluesit.*

- Lidhur me konstatimet e pikës 5 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Për sa i përket Rregullores specifike për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në momentin e parë bëhet instruktim i punonjësve të marrë në punë dhe gjatë gjithë kohës jemi shumë të vëmendshëm që çdo informacion i klientëve të jetë i fshehtë...".*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Referuar nenit 27 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin të mbajë dokumentacion për veprimtaritë e tij përpunuese në mënyrë që të jetë në gjendje të japë të dhëna lidhur me përputhshmërinë me këtë ligj. Në këtë kuadër, mosdisponimi i një rregulloreje të brendshme për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, sipas kërkesave të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, demonstron mungesë të rregullimit të brendshëm për pajtueshmëri dhe mungesë të kapaciteteve organizative për garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes së të dhënave personale. Ky fakt e zgjeron dimensionin e shkeljes përtej një veprimi të vetëm, duke i dhënë natyrë të vazhdueshme dhe strukturore sjelljes së paligjshme.

- Lidhur me konstatimet e pikës 6 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Të dhënat ruhen në sistemin Amadeus, i cili ruan të dhënat deri në momentin që kryhet udhëtimi. Sistemi ka pjesë të veçanta dhe vendos gjithmonë rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale...*".

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Sa i përket pretendimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit vlerëson se krijimi i procedurave dhe politikave për mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit për proceset përpunuese të Kontrolluesit, si dhe zbatimi praktik i tyre, është një ndër masat kryesore që duhet të marrë Kontrolluesi, në lidhje me sigurinë e të dhënave personale.

- Lidhur me konstatimet e pikës 7 të procesverbalit të hetimit administrativ, Kontrolluesi pretendon se, "*Nuk kemi qenë në dijeni që duhet të kemi një vendim asambleje apo në çfarë dokumenti duhet të pasqyrohet fakti që Kontrolluesi është Administratori i shoqërisë, duke qenë ortak i vetëm e ka këtë të drejtë të vetvendosë, do kujdesemi që ta kemi dhe të shkruar si vendim asambleje të ortakut të vetëm. Por gjithsesi kjo nuk përbën shkelje të nenit 33 të ligjit, pasi shoqëria/kontrolluesi ka vetëm 7 (shtatë) punonjës aktiv që punojnë në ambientet e zyrës dhe të gjithë janë në një ambient të përbashkët, 1 punëtor pastrimi, 1 është vetë administratori, 1 punonjës marketingu që nuk qëndron në zyrë por është në lëvizje, 1 punonjëse me leje lindje (ne total 11 persona) dhe përpunimi i të dhënave nuk kryhet në shkallë të gjerë...*".

  Zyra e Komisionerit vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm dhe ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese, që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

  Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit në rastin e caktimit të një nëpunësi të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre, sipas këtij Ligji.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si mos dokumentimi për veprimtaritë përpunuese të Kontrolluesit, mungesa e hartimit të rregullores, mungesa e masave shtesë teknike dhe organizative në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, në kuptim të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 94 të Ligjit, si dhe përpunimi i të dhënave personale përmes CCTV në ambientet e brendshme në kuptim të shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, gjithashtu mungesa e publikimit të rubrikës "*Politikat e Privatësisë*" në faqen zyrtare të internetit të Kontrolluesit, në kuptim të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 94 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

"*1. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93 të këtij ligji, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 1 000 000 000 (një miliard) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare deri në 2% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado është më e lartë, shkeljet e detyrimeve:*
a) të kontrolluesit dhe përpunuesit, sipas neneve 8, pika 6, e 11, të kapitullit III, të pjesës II të këtij ligji, me përjashtim të nenit 22 të këtij ligji;

2. Bazuar edhe në rrethanat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 93, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë deri në 2 000 000 000 (dy miliardë) lekë, ose në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros totale vjetore globale për vitin financiar paraardhës, cilado që është më e lartë, shkeljet e mëposhtme:

a) moszbatimi i parimeve themelore të përpunimit, përfshirë kushtet për dhënien e pëlqimit, sipas neneve 6, 7, 8 e 9, të këtij ligji;
b) shkeljet e të drejtave të subjekteve të të dhënave sipas neneve 12–20 të këtij ligji;"

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nuk përmbush kërkesat e parashikuara nga Ligji dhe nuk mund të konsiderohet si provë e mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e masave të nevojshme organizative dhe teknike që Kontrolluesi ka detyrimin të zbatojë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Rrjedhimisht, aktet e referuara nuk prodhojnë efekt juridik për qëllime të zbatimit të Ligjit.

Në rrethanat e shqyrtimit të kësaj çështje, Zyra e Komisionerit evidenton shkallën e bashkëpunimit nga ana e Kontrolluesit. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë xhiron vjetore të deklaruar nga Kontrolluesi, si dhe rëndësinë e proceseve përpunuese.

Sa më sipër, mbështetur në dispozitat e Udhëzimit nr. 06, datë 16.07.2025, "*Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative*", veçanërisht në pikat 7 dhe 8, të Seksionit 2.3 të Kapitullit 2 dhe të Kapitullit 4, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe transparente masën e sanksionit administrativ ndaj Kontrolluesit, sipas përcaktimeve të neneve 93 dhe 94 të Ligjit, duke u bazuar në kufijtë minimalë të përllogaritjes.

Komisioneri vlerëson faktin se, shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave, me informimin dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme tekniko-organizative për sigurinë e të dhënave personale. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të Kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 7, 13, 26, 27, 28, 33, 34, 81-84, pikës 1 të nenit 87, nenit 93, shkronjës "a" të pikës 1 dhe shkronjave "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 94, si dhe nenit 95 të Ligjit, dhe të ligjit nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "*Për kundërvajtjet administrative*", Komisioneri,

V E N D O S I:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **400,000** (katërqind mijë) Lekë, për shkelje të neneve 6, 7 dhe 13 të Ligjit;

2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën **800,000** (tetëqind mijë) Lekë, për shkelje të neneve 26, 27 dhe 28 të Ligjit;

3. Kontrolluesi, të ndalojë monitorimin e punonjësve në vendin e punës përmes sistemit të survejimit CCTV, si dhe të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat "*video/audio*" të mbledhura për subjektet e të dhënave "*punonjës*", të cilat janë përpunuar, në kundërshtim me dispozitat e neneve 6 dhe 7 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për publikimin dhe përditësimin e rubrikës "*Politikat e Privatësisë*" në faqen e internetit, në lidhje me informimin e subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;

5. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar kontratën me përpunuesin duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;

6. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të marrë masa për hartimin e rregullores "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;

7. Kontrolluesi, të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;

8. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale; [1]

9. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48; [2]

10. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

i. menjëherë, detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më sipër;
ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 4 më sipër;
iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 5, 6 dhe 7 më sipër;
iv. brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 8 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

11. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;

12. Vendimi për gjobë përbën titull ekzekutiv dhe zbatohet nga kundërvajtësi (Kontrolluesi), brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit. Për ekzekutimin e gjobës ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor;

13. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve nga data e njoftimit.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 13.02.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

[1] Udhëzimi nr. 47 dhe Udhëzimi nr. 48 janë shfuqizuar me Udhëzimin nr. 08, datë 20.11.2025 "*Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues*";
[2] Detyrimet e parashikuara në Udhëzimin nr. 47 dhe nenin 5, të Udhëzimit nr. 48, vijojnë sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 "*Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale*".